



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2022

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi - Arsimi i orientuar (artistik dhe sportiv) dhe arsimi profesional Varianti B

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

Arritja e suksesit përmes raporteve të mira njerëzore

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

| | | |
|-----------|---|--------|
| Pyetja 1 | C | 1 pikë |
| Pyetja 2 | A | 1 pikë |
| Pyetja 3 | C | 1 pikë |
| Pyetja 4 | A | 1 pikë |
| Pyetja 5 | C | 1 pikë |
| Pyetja 6 | B | 1 pikë |
| Pyetja 7 | D | 1 pikë |
| Pyetja 8 | D | 1 pikë |
| Pyetja 9 | A | 1 pikë |
| Pyetja 10 | A | 1 pikë |

Pyetja 11

2 pikë

Përgjigje:

libra OSE librat

grupe OSE grupet

2 pikë Nëse nxënësi gjen shumësin e të dy emrave (të shquar ose të pashquar).

1 pikë Nëse nxënësi gjen shumësin e njërit prej emrave OSE nëse jep dy variante shumësi të njërit nga emrat.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, OSE nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 12

4 pikë

Përgjigje:

Mbiemri: i mirëpritur Lloji: i nyjshëm

Shënim: Do të konsiderohet si përgjigje e saktë edhe nëse nxënësi jep si përgjigje: mbiemër marrëdhënior (klasifikimi kuptimor) ose mbiemër i përbërë (nga pikëpamja e fjalëformimit).

Ndajfolja: kudo Lloji: ndajfolje vendi

4 pikë Nëse nxënësi gjen mbiemrin dhe llojin e tij si edhe ndajfoljen dhe llojin e saj.

3 pikë Nëse nxënësi gjen mbiemrin dhe ndajfoljen dhe një nga llojet e tyre.

2 pikë Nëse nxënësi gjen mbiemrin dhe ndajfoljen.

1 pikë Nëse nxënësi gjen mbiemrin OSE ndajfoljen.

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 13

3 pikë

Përgjigje:

Kundrinori: Sekretin

Lloji: Kundrinor i drejtë.

Me çfarë është shprehur: Shprehet me emër në rasën kallëzore.

3 pikë Nëse nxënësi gjen kundrinorin, llojin e tij dhe se me çfarë është shprehur.

2 pikë Nëse nxënësi gjen kundrinorin dhe nëse shkruan se është kundrinor i drejtë OSE gjen kundrinorin dhe shkruan se me çfarë është shprehur,

0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 14

3 pikë

Përgjigje:

ky: përemër dëftor
mendim: emër
të ndryshme: mbiemër

3 pikë Nëse nxënësi gjen të tri klasat e fjalëve.
2 pikë Nëse nxënësi jep dy nga klasat e fjalëve.
1 pikë Nëse nxënësi jep një nga klasat e fjalëve.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 15

4 pikë

Model përgjigjeje:

Karakteristikat:

- Përdorimin e foljeve në kohën e tashme, në kohën e shkuar, përdorimin e foljeve modale për të treguar qëndrimin e folësit, përdorimin e foljeve në formën joveprore etj.
- Teksti ka citime nga autorë, emra njerëzish të famshëm, ose shprehje të njohura, që janë pjesë e përvojës njerëzore. Ka pyetje në funksion të problemit që shtrohet, apo në funksion të bindjes së lexuesit.
- Gjuhë e thjeshtë, objektive. Ka përgjithësime, ka detaje, fakte, shembuj, prova. Ndonjëherë përcjell emocion.
- Në fragment kemi përdorimin e një leksiku të specializuar për temën dhe llojin e tekstit, përsëritjen e fjalëve kyçe etj.
- Përdorimi i konektorëve të tillë si: ndajfolje, lidhëza, fjalë lidhëse, përdorimi i përemrave etj.

4 pikë Nëse nxënësi gjen dy nga karakteristikat e përshkruara me lart, të konkretizuara me shembujt përkatës.
3 pikë Nëse nxënësi gjen dy karakteristika dhe një shembull.
2 pikë Nëse nxënësi gjen dy karakteristika **OSE** një karakteristikë dhe një shembull.
1 pikë Nëse nxënësi gjen një karakteristikë.
0 pikë Nëse nxënësi nuk gjen asgjë, ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të nxënësit, që nuk është si formulimet më lart, por që në një mënyrë tjetër, të çon në veçori gjuhësore të tekstit.

PJESA II Naim Frashëri "Bukuria"

| | | |
|-----------|---|--------|
| Pyetja 16 | D | 1 pikë |
| Pyetja 17 | C | 1 pikë |
| Pyetja 18 | C | 1 pikë |
| Pyetja 19 | B | 1 pikë |
| Pyetja 20 | A | 1 pikë |
| Pyetja 21 | D | 1 pikë |
| Pyetja 22 | A | 1 pikë |
| Pyetja 23 | A | 1 pikë |
| Pyetja 24 | B | 1 pikë |
| Pyetja 25 | C | 1 pikë |

Pyetja 26 3 pikë

Lloji i rimës: Rima e përdorur është e kryqëzuar **OSE** Rima është abab.
 Shembulli: Shkruan njëren nga strofat katërshe.
 Roli i rimës: I jep vargut ritëm dhe muzikalitet.

3 pikë Nëse nxënësi gjen llojin e rimës, një shembull dhe muzikalitetin ose ritmin.
2 pikë Nëse nxënësi gjen llojin e rimës dhe jep një shembull **OSE** llojin e rimës dhe rolin e saj **OSE** shembullin dhe rolin e rimës
1 pikë Nëse nxënësi gjen llojin e rimës **OSE** jep shembullin.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 27 1 pikë

Përgjigje:
 Strofa e pestë **OSE** nëse rimerret strofa dhe shkruhet.

1 pikë Nëse nxënësi shkruan *strofa e pestë* **OSE** nëse e shkruan atë të gjithën **OSE** mund të shkruajë edhe vetëm vargun e fundit të strofa e pestë.
0 pikë Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 28

3 pikë

Model përgjigjeje:

Portretizimi i vajzës mund të jepet me një ose disa fjali. E rëndësishme është që të përshtatet me përftyrimin e poetit. Portretizimi të përmbajë detaje, që e përshkruan vajzën si figurë konkrete dhe imagjinare, me tipare nga bukuria e saj, të përdorë figura letrare si: krahasimi, epiteti, metafora, etj.

- 3 pikë** Nëse gjatë portretizimit dalin tri nga tiparet e vajzës. Pranohen si përgjigje të sakta edhe fjalë a shprehje të përafërta, që të shpien në përftyrimin magjik të poetit për vajzën.
- 2 pikë** Nëse dalin dy nga tiparet e dhëna. Pranohen si përgjigje të sakta edhe fjalë a shprehje të përafërta, që të shpien në përftyrimin magjik të poetit për vajzën.
- 1 pikë** Nëse del vetëm njëra nga tiparet e dhëna. Pranohen si përgjigje të sakta edhe fjalë a shprehje të përafërta, që të shpien në përftyrimin magjik të poetit për vajzën.
- 0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare, ose ajo çfarë nxënësi shkruan nuk ka lidhje me tipare fizike dhe shpirtërore.
-

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje:

Përvuajtja e poetit ndihet në vargjet ku ai tregon sa vuan dhe sa i përlurur është para dashurisë, ndërsa ngurrimi, që shkon ndonjëherë deri në shtangje (mbetet i pagojë) para bukurisë, shprehet në vargjet, që tregojnë përmasën e saj të madhe.

Vargjet:

Se m'u bë zëmra thërrime
Shpirtin mos ma përvëlo.

Mos më vdis e mos më sos
Nuk' e them dot atë ndjenjë.

Zëmrën e vafrë ma piku

- 2 pikë** Nëse nxënësi shkruan vargjet që tregojnë vuajtjen e heroit dhe ato që tregojnë sa ngurron ai para saj, sa e mahnit ajo, aq sa heroi ndalet një moment dhe e shijon atë, i mbetur pa fjalë.
- 1 pikë** Nëse jep vetëm një shembull.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 30**3 pikë****Model përgjigjeje:****Krahasimet:**

Si thëllëz' e bukur mos shko

Mos vështro si pëllumbeshë

Mos u tund si mbretëreshë

Duke kthyer si shigjeta

Me qepallat si shtijë

Me vështrim posi shkëndijë

Roli artistik: Roli artistik i figurës lidhet me tiparin kryesor të romantizmit, që e përdor krahasimin si figurë shprehëse për të nxjerrë në pah bukurinë e vajzës, ose të shprehë përmasën e bukurisë, të japë larminë e bukurisë, forcën goditëse, magjepsëse, madhështore të saj ta krahasojë me dukuri nga natyra.

3 pikë

Nëse nxënësi gjen dy nga krahasimet në fragment dhe shpjegon rolin artistik.

2 pikëNëse nxënësi gjen vetëm dy nga krahasimet, **OSE** një nga krahasimet dhe shpjegon rolin artistik.**1 pikë**

Nëse nxënësi shkruan vetëm një nga krahasimet.

0 pikë

Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Pyetja 31**4 pikë****Model përgjigjeje:**

Për tiparet e letërsisë popullore në të cilat mbështetet Naim Frashëri në poemthin "Bukuria", nxënësi mund të japë dy nga variantet e mëposhtme:

- Vendosja e figurës së vajzës në qendër të poemthit, herë konkrete, herë abstrakte.
- Prania e dukshme e heroit lirik.
- Figuracioni i mbushur me krahasime, epitete, metafora, hiperbola etj. Efektet artistike të figurave letrare dhe detajeve.
- Portretizimi, idealizimi dhe universalizimi i të bukurës dhe dashurisë.
- Metrika: lloji i vargut, strofës, rimës.
- Muzikaliteti ose ritmi.
- Fjalët me ngarkesë të veçantë emocionale.

4 pikë

Nëse nxënësi shkruan dy nga tiparet, me shembuj përkatës.

3 pikë

Nëse nxënësi shkruan dy nga tiparet dhe një shembull.

2 pikëNëse nxënësi shkruan dy nga tiparet **OSE** një nga tiparet dhe një shembull.**1 pikë**

Nëse nxënësi shkruan një nga tiparet.

0 pikë

Nëse përgjigjja është gabim, ose nuk ka përgjigje fare.

Shënim: Në rast se nxënësi jep një përgjigje tjetër nga modeli i dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë, ai do të marrë pikët e plota.

PJESA III

Pyetja 32 8 pikë

Për pjesën *ese* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë 2 pikë

- shkruan një *ese*, ku argumenton pse nëpërmjet profesionit që do të zgjedhin do të arrijnë sukses .
- zbërthen argumentet e dhëna përmes detajesh të shumëllojshme shpjeguese dhe përshkrimi mbështet shpjegimin përgjatë gjithë shtjellimit;
- sjell përvoja të ndryshme personale, të cilat mbështetin bindshëm argumentin.

Organizimi dhe struktura 2 pikë

- përdor strukturë të qartë *eseje*: hyrje-zhvillim-mbyllje.
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti 2 pikë

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një pershtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore 2 pikë

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e *esesë*;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e *esesë*, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysh, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i *esesë* është një nxënës dhe jo një shkrimtar.

Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.

